



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

## **RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR 2014**

**Janar 2015**

**SHKURTIME**

AB	Auditi i Brendshëm
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI	Banka Europiane e Investimeve
CEB	Banka e Këshillit të Europës
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve
DZHR	Departamenti i Zhvillimit Rajonal
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulencës Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GoA	Qeveria Shqiptare
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
IDB	Banka Islamike e Investimeve
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KZHR	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
NTA	Norway Trust Account
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
PNMZM	Plani i Ndjekjes së Masave Zbutëse mbi Mjedisin
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
ToR	Terma Reference
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WBIF	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)

**Pasqyra e lëndës**

1. PËRMBLEDHJE .....	4
2. Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore .....	7
3. Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri” .....	8
4. Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale .....	14
4.1 “Furnizimi me Ujë I Zonave Rurale I & II” .....	15
4.2 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” , SIF IV .....	16
5. AKTIVITETI INSTITUCIONAL .....	18
5.1 Menaxhimi Financiar .....	18
▪ 19	
5.2 Komunikimi dhe Informimi .....	23
5.3 Monitorimi dhe Vlerësimi .....	24
5.4 Auditimi i brendshëm .....	25
5.5 Misione të Donatoreve .....	27
6. AKTIVITETE TE TJERA .....	28
6.1 Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja .....	28
6.2 Projekte të bashkëfinancuara nga Bashkimi European në kuadër të Programit IPA .....	28
6.2.1 IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës .....	28
6.2.2 IPA 2013 – Përmirësimi i rrugëve dhe sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale .....	28
6.2.3 IPATECH - Teknologji në miniaturë: sinergjia e kërkimeve dhe risive për të përmirësuar zhvillimin ekonomik të Adriatikut .....	29
6.2.4 Projekti MONTEAL .....	29
6.2.5 Projekti HERA .....	29
6.3 Programi i Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut .....	30
6.4 Përgatitja e Masterplanit për Zonën e Alpeve .....	30
6.5 Bashkëpunimi strategjik Shqipëri-Kosovë .....	30
6.6 Aktivitete të tjera .....	31

## 1. PËRMBLEDHJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë këtij viti është angazhuar intensivisht në përmbushjen e misionit të tij për nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm, në nivel rajonal dhe lokal për të arritur sa më mirë objektivat e Qeverisë Shqiptare për një zhvillim të integruar e harmonik të vendit.

Viti 2014 karakterizohet nga një sërë programesh dhe projektesh të financuara të cilat vijnë si përmbushje e angazhimit programor të Qeverisë duke synuar stimulimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social të komuniteteve përmes injektimit të drejtpërdrejtë të fondeve nepërmjet investimeve.

Gjatë këtij viti, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 75.87 milionë Euro ose në masën 90% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar.

Investimet në infrastrukturë gjatë vitit 2014 zënë peshën kryesore të aktivitetit institucional të FSHZH-së. Gjatë kësaj periudhe, FSHZH është angazhuar me të gjitha kapacitetet e veta njerëzore dhe teknike për të realizuar me sukses një sërë projektesh të infrastrukturës urbane dhe rurale, me shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse.

Viti 2014 ka shënuar një aktivitet intensiv në **bashkëpunimin me Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve**. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve pësoi gjatë këtij viti një transformim të rëndësishëm, nga një instrument financimi i projekteve të vogla me impakt të kufizuar, drejt financimit të projekteve më të mëdha me ndikim rajonal, në funksion të vizionit të transformimeve urbane të qendrave të qyteteve të mëdha.

Ndryshe nga vitet e tjera, ky vit përveç funksionit vlerësues dhe monitorues të projekteve infrastrukturore të zbatuara në të gjithë vendin përmes financimeve të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, i shtoi FSHZH dhe funksionin e zbatuesit. Duke vlerësuar kapacitetet dhe performancën e lartë të FSHZH, Qeveria Shqiptare i akordoi gjatë vitit 2014 zbatimin e 30 objekteve të ndryshme me një vlerë prej rreth 40 Milionë USD.

Në kuadër të Programit **“Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”**, gjatë vitit 2014 FSHZH ka ndjekur zbatimin e 52 segmenteve rrugore dhe urave në një gjatësi prej 432 km. Që nga fillimi i programit deri fund të vitit 2014, FSHZH ka financuar rikonstruksionin e 142 segmenteve rrugore dytësore & lokale dhe urave, me një gjatësi totale prej rreth 1170 km. Muaji Qershor 2014 shënoi edhe mbylljen përfundimtare të financimeve nga CEB (Banka e Këshillit të Europës) në kuadër të këtij projekti me vlerë financimi prej 40 milionë Euro. Ndërkohë vijojnë punën projektet me financim nga EBRD, EIB, KfW, OFID, IDB dhe IPA 2009 – 2010 – 2011.

**Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”**, ka përfunduar punimet infrastrukturore për 29 skema ujësjellësish në qarqet Dibër, Kukës dhe Shkodër. Gjatë këtij viti ka vijuar puna për ndjekjen e periudhës së garancisë, riparimit të defekteve dhe dorëzimin e ujësjellësave pranë NJQV-ve përfituese. Ndërkohë në kuadër të “SIF IV” janë përzgjedhur për financim 15 skema të tjera ujësjellësash të cilët kanë filluar zbatimin e punimeve civile gjatë muajit Korrik 2014. Gjatë vitit 2014 kanë vijuar negociatat në kuadër të Projektit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” i cili parashikon ndërhyrje në shkallë të gjërë në të gjithë vendin.

Në funksion të programit dhe strategjisë së re qeveritare stafi i FSHZH-së është angazhuar në përgatitjen dhe aplikimin pranë donatorëve dhe sigurimin e fondeve për financim dhe zbatimin e projekteve të reja të investimeve, me fokus në zhvillimin urban dhe turistik.

Një aktivitet i rëndësishëm i zhvilluar në këtë kuadër është edhe puna e kryer për hartimin e Programit të Investimeve Kapitale të Bregdetit të Jugut, në bashkëpunim me Qeverinë

Shqiptare, NjQV-të, dhe deputetët e Qarkut Vlorë. Plani paraqet projektet prioritare të infrastrukturës parësore vendore dhe rajonale, rrugë urbane, rrugë rurale, ujësjellës – kanalizime e rikualifikime urbane. Objektivi i këtij plani është që me mbështetjen e Qeverisë dhe Donatorëve kjo iniciativë të konkretizohet në një program të integruar zhvillimi që do të ridimensionojë turizmin në këtë zonë.

Përgatitje intensive janë zhvilluar edhe për inicimin e programit për Zhvillimin i Alpeve Shqiptare dhe zonës bregdetare të vendit, i cili mbështetet financiarisht nga CEB dhe Qeveria Shqiptare dhe parashikohet të fillojë zbatimin gjatë vitit 2015.

Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellës, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat do të përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësave Rurale III, i cili parashikohet të këtë shtrirje në të gjithë vendin.

FSHZH ka përgatitur një studim fizibiliteti për rrugën e Lumit të Vlorës, i cili i është dërguar pranë Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik për të mundësuar financimin etij.

Progres është shënuar edhe përsa i përket Projekteve, të financuara nga fondet e Instrumentit të Para Aderimit (IPA), programet e bashkëpunimit ndërkufitar, HERA, MONTEAL, IPATECH dhe projekti për financimin e Lungomares.

Një tjetër angazhim i FSHZH në vitin 2014 ka qenë edhe kontributi në bashkëpunimin strategjik mes Shqipërisë dhe Kosovës. Për këtë arsye që nga fillimviti Fondi Shqiptar i Zhvillimit u përfshi në përpjekje për rivitalizimin e angazhimit për bashkëpunim të ngushtë institucional, ekonomik e kulturor mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Gjatë këtij viti, ka vijuar realizimi me sukses i një fushate për informimin publik përmes mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilës është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së si dhe aktivitetet në vijim.

Vlen për tu theksuar se gjatë këtij viti ka vijuar bashkëpunimi intensiv dhe i suksesshëm me ministritë e linjës dhe agjencitë shtetërore, si Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, etj.

## Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2014

Donatori	Totali	Projektet në fazën e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci	Mbyllur Përfundimisht në Dhjetor 2014
KfW (RWS)	29					7	22
KfW (SIF IV) Water Component	15	1			14		
IDA GOA (SLRP)	9					1	8
OFID I & II (SLRP)	22				1	9	12
CEB (SLRP)	32						32
IPA 2008 (SLRP)	4						4
IDB – ISTISNA (SLRP)	13				1	5	7
EBRD, EIB & IPA 2010-2011(SLRP)	57		1		12	33	11
IPA 2013 (Lungomare)	1	1					
KfW & IPA 2009 (SLRP)	7	1			5	1	
PIK Bregdeti i Jugut	143	143					
Qeveria Shqiptare 2014 (FZHR)	30	9	5	6	9	1	
<b>TOTALI</b>	<b>362</b>	<b>155</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>42</b>	<b>57</b>	<b>96</b>

## 2. Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore

Viti 2014 shënoi një transformim të rëndësishëm të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, nga një instrument financimi i projekteve të vogla me impakt të kufizuar, drejt financimit të projekteve më të mëdha me ndikim rajonal, në funksion të vizionit të transformimeve urbane të qendrave të qyteteve të mëdha.

Ndryshe nga vitet e tjera, ky vit përveç funksionit vlerësues dhe monitorues të projekteve infrastrukturore të zbatuara në të gjithë vendin përmes financimeve të Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, i shtoi FSHZH dhe funksionin e zbatuesit. Duke vlerësuar kapacitetet dhe performancën e lartë të FSHZH, Qeveria Shqiptare i akordoi gjatë vitit 2014 zbatimin e 30 objekteve të ndryshme me një vlerë prej rreth 40 Milionë USD.

### 2.1.1 Zbatimi i projekteve të akorduara nga FZHR për vitin 2014.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një nga përfituesit më të mëdhenj të fondeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Gjatë vitit 2014 janë miratuar 30 objekte të ndryshme me vlerë totale 4.43 miliardë lekë të cilat do të zbatohen nga FSHZH. Këto financime janë fokusuar në 4 drejtime prioritare:

- (i) 10 projekte për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj urbane, (Hyrjet e Tiranës nga Durrësi dhe Elbasani, rruga e Dajtit dhe Gjirit të Lalzit, Sistemimi i 2 shesheve në Tiranë, Ura e Zvërnecit, Unaza e Divjakës, Rruga Transballkanike në Vlorë, Mbushja me rërë e plazhit Vlorë, Rruga hyrëse e Dardhës, etj);
- (ii) 5 Projekte të furnizimit me ujë (ujësjellesat në Sarandë, Dhërmi, Ksamil dhe Manastir);
- (iii) 9 Projekte mjedisore dhe gjelbërimi (Pyllëzimi i Krastës në Krujë, Gjelbërimi i aksit rrugor Plepa – Vlorë, Gjelbërimi i vijës bregdetare të Vlorës dhe Parkut të Liqenit Artificial në Tiranë; Gjelberimi i aksit Levan – Kakavije, Lushnje Berat, IKV- Surrel etj);
- (iv) 6 projekte studimore, trashëgimi kulturore dhe të dhëna hapësinore (përgatitja e projektit teknik për Lungomaren, Restaurimi dhe Muzealizimi i Fototekës Marubi, dhe projekti i krijimit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit rajonal, përgatitjes së projekteve për vitin 2015 etj.

**Projektet e infrastruktures rrugore.** Aktualisht ka filluar zbatimi i punimeve në 3 projekte, 4 projekte të tjera janë në proces kontraktimi dhe punimet pritet të fillojnë gjatë muajit Janar 2015, 2 objekte janë në tenderim dhe 1 në fazën e përgatitjes së dokumentacionit, i cili parashikohet të shpallet për tenderim brenda muajit Janar 2015.

**Projektet e furnizimit me ujë në zonën e Brengdetit të Jugut.** Puna ka filluar në të gjitha skemat e ujësjellësave, dhe po punohet kryesisht me linjat kryesore dhe ato të shpërndarjes, depot e ujit, stacion pompimi etj.

**Projektet mjedisore.** Aktualisht kanë përfunduar punimet e mbjelljes së fidanëve në Krastë të Krujës. Në segmentin Plepa - Vlorë punimet po ecin sipas parashikimit. Në këtë aks vlen të përmendet që dy kompani gjelbërimi nga Kavaja dhe Lushnja kanë mbjellë vullnetarisht pemë në dy segmente të kësaj rruge. Projekti i gjelbërimit të Liqenit Artificial pritet të shpallet për tenderim në Janar 2015. Për sa i përket gjelbërimit të akseve kombëtare si Levan – Kakavijë, Lushnje – Berat, si dhe IKV- Surrel janë përgatitur projektet e plota të zbatimit dhe në bashkëpunim me ARRSH jemi duke studiuar zgjidhjet teknike, për ti përshtatur me kodin

rrugor në fuqi. Këto projekte parashikohet të shpallen për tenderim brenda muajit Janar 2015.

**Projektet studimore, hapësinore, të trashigimisë kulturore, etj.** Në kuadër të këtyre projekteve vlen të përmendet angazhimi i FSHZH në përgatitjen e disa projekteve të rëndësishme si përgatitja e projektit teknik të fazës së dytë të Lungo Mares, përgatitja e master planit të turizmit, një projekt bashkohor për restaurimin dhe muzealizimin e fototekës Marubi, krijimin e sistemit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit dhe menaxhimit rajonal, hartimin e projekteve për zonën Tiranë – Durrës dhe Bregdetin e Jugut, etj.

### **2.1.1 Monitorimi i Investimeve të NJQV-ve në kuadër të FZHR.**

Gjatë vitit 2014 Fondi Shqiptar i Zhvillimit është angazhuar me të gjitha kapacitetet e tij për vlerësimin, studimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të FZHR për vitin 2014. Gjatë periudhës Mars – Dhjetor 2014, FSHZH ka vlerësuar dhe ka dërguar për financim pranë FZHR 135 objekte të infrastrukturës rrugore, ujësjellësa, projekte mjedisore, arti kulturë, sheshe e qendra urbane, projekte studimore dhe zhvillimore.

FSHZH ka ndjekur dhe monitoruar ecurinë tekniko-financiare të objekteve të infrastrukturës vendore miratuar për NJQV-të. Ky monitorim për secilin objekt është kryer minimalisht dy herë në muaj dhe ka konsistuar në raportimin e ecurisë së projekteve, përqindjes së realizimit të investimit si dhe një përshkrim rreth punimeve që janë kryer në objekt. Informacioni i përgatitur i është dërguar FZHR-së dhe Ministrive të Linjës.

Gjatë periudhës Tetor – Nëntor 2014, FSHZH u angazhua në standartizimin e projekteve të terreneve sportive financuar nga FZHR 2014. Ky proces parashikonte njësimin e shtresave, ndriçimit dhe rrethimit për terrenet sportive të disa shkollave në qarqet Lezhë, Kukës, Fier, Vlorë, Durrës, Korçë, Elbasan dhe Berat.

Paralelisht angazhimit për projektet e reja, FSHZH gjatë vitit 2014 ka qënë e angazhuar edhe në monitorimin e ecurisë tekniko-financiare të 165 objekteve të infrastrukturës rrugore në zbatim miratuar nga FZHR 2012 - 2013, me vlerë rreth 7,6 miliardë lekë. Është kontrolluar në terren dhe dokumentacioni përkatës pranë NJQV-ve i këtyre objekteve.

Gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2014, FSHZH u angazhua në përgatitjen e materialeve informuese, grumbullimin dhe katalogimin e projekteve të infrastruktures vendore të propozuara nga 61 NJQV-të, që do të jenë qendrat e bashkive të reja pas reformës territoriale, lidhur me hartimin e projekteve teknike prioritare për financim nga FZHR 2015. Të gjitha projekt-propozimet iu dërguan Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për të kryer përzgjedhjen e projekteve prioritare. Ky proces vijon edhe gjatë vitit 2015.

*Aneks 7.1 Lista e plotë e objekteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me financim të FZHR-së (Dhjetor 2014)*

### **3. Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri”**

Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, bashkëfinancuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe Donatorë të tjerë në vlerën 368 milionë USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si dhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal.



Programi, deri në Dhjetor 2014, është financiar në shumën rreth 368 milionë USD dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij.

Donatori	Financimi (milionë)
<sup>1</sup> BB	20 USD
OFID (OPEC) I & II	25 USD
GoA	9 USD
CEB	40 EUR
NTA	0.18 EUR
IPA 2008	8 EUR
BERZH	50 EUR
BEI	50 EUR
IDB/ ISTISNA	40 USD
KfW	15 EUR
IPA 2009	8.8 EUR
IPA 2010	20 EUR
IPA 2011	14.5 EUR
WBIF	4 EUR
DEVOLL HYDRO POWER	0.76 EUR
<sup>2</sup> Total (milionë USD)	367.62 USD


Që nga fillimi i zbatimit të PRDL deri më 31 Dhjetor 2014, FSHZH ka financiar rikonstruksionin e 142 segmenteve rrugore dytësore & lokale dhe urave, me një gjatësi totale prej rreth 1170 km.

Gjatë vitit 2014 në kuadër të zbatimit këtij programi, FSHZH ka ndjekur zbatimin e 52 segmenteve rrugore dhe urave në një gjatësi prej 432 km. Nga këto kanë përfunduar punimet në 33 segmente rrugore ose 241 km, duke e çuar në 949 numrin e kilometrave të përfunduara në kuadër të të gjithë programit. Ndërkohë vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 19 rrugë me një gjatësi prej 192 km. Njëkohësisht janë financiar edhe 3 kontrata të rritjes dhe përmirësimit të sigurisë rrugore, të cilat kanë përfunduar punimet. Në proces tenderimi/kontraktimi është segmenti Qeparo - Kudhës 9.55 km i gjatë. Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik janë 2 segmente të tjera rrugore ku përfshihen projektet për ndërtimin e Lungo Mares në Vlorë, dhe loti i dyte i rruges Tamarë - Vermosh.

## Ecuria e deritanishme e projektit

<sup>1</sup> Në marrëveshje financimi është 12.2 milionë SDR

<sup>2</sup> Kursi mesatar i këmbimit për periudhën 2008 – 2014 Eur/USD = 1.30



**Komponenti i parë:** Financimi i aktiviteteve mbështetëse të programit:

Financimi i aktiviteteve mbështetëse të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” është komponenti i parë i cili në thelb të tij ka një sërë procesesh kyçe dhe mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e programit. Inventarizimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, hartimi i projekteve teknike, zbatimi i procedurave transparente të prokurimit, supervizimi dhe konsulenca e specializuar ndërkombëtare, aplikimi i procedurave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, funksionim – mirëmbajtja dhe ngritja e kapaciteteve kanë qënë disa nga proceset kyçe që kanë kontribuar në zbatimin me sukses të këtij programi.

**Inventarizimi rrjetit rrugor dytësor dhe lokal**

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit. Nga një total prej 9800 km rrugë dytësore dhe lokale, ka përfunduar inventarizimi i plotë me të dhëna të detajuara për rreth 4247 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Për çdo segment rrugor, i cili është pjesë e këtij inventari, janë mbledhur të dhëna të hollësishme, si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon si edhe varfëria në zonë. Është bërë një analizë shumëkriterëshe për secilin nga këto seksione, e përbërë nga disa komponentë. Paralelisht me zhvillimin e këtij procesi, vijon puna për përditësimin e të dhënave ekzistuese në inventar, duke i rifreskuar me të dhënat aktuale të rrugëve të rikonstruara, ose në proces rehabilitimi. Në fund të vitit 2014 rezulton se kjo analizë është kryer për rreth 613 km rrugë.

**Hartimi i projekteve teknike**

Përsa i përket hartimit të projekteve teknike, që financohen në kuadër të këtij programi, janë projektuar 1200 km rrugë. Për këtë proces janë kontraktuar disa kompani të cilat kanë përgatitur dhe dorëzuar projektet teknike, përgatitjen e dokumentave të prokurimit dhe instrumentave mbrojtës shoqëruar. Për të gjitha projektet janë plotësuar dosjet me projektin, preventivin dhe gjithë dokumentacionin përkatës. Një pjesë e segmenteve rrugore kanë pasur projekte teknike të hartuara nga NJQV-të përkatëse. Këto projekte janë kontrolluar dhe rishikuar nga Njësia e Mbështetjes Teknike pranë FSHZH-së dhe janë dërguar për ripunim në rastet kur ka qënë e nevojshme. Paralelisht me kontrollin e projekteve teknike kryhet edhe hedhja e gjurmës së rrugëve në Google Earth. Për periudhën Janar – Dhjetor 2014, janë kontrolluar dhe ripunuar 63 projekte teknike, përfshirë këtu edhe projektet e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve 2014. Njëkohësisht në kuadër të Programit të Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut është punuar për kontrollin dhe rishikimin e projekteve teknike të ardhura nga NJQV-të përfituese. Është punuar gjithashtu për kontrollin e 11 projekteve të cilat parashikohet të financohen nga IDB dhe hartimin e fizibilitetit të rrugës së lumit të Vlorës i cili i është prezantuar dhe dorëzuar pranë Fondit Kuvajtian për të mundësuar financimin.

**Prokurimi**

Procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”. Rrugët e financuara nga BERZH dhe BEI janë prokuruar në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit të Projektit për Rrugët Dytësore dhe Lokale dhe Udhëzuesit e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, publikuar në janar të 1992 dhe rishikuar në maj të 2010. Rrugët e financuara nga Banka Botërore, GoA, OFID, dhe CEB, janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”. Ndërkohë prokurimi i punimeve civile për rrugët e financuara nga IDB, po

kryhet sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009 tenderohen sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”.

### Supervizimi i kontratave të punimeve civile

Supervizimi i kontratave të punimeve civile të rrugëve dytësore dhe lokale kryhet nga kompania JV IRD& Eptisia e cili kryen shërbimet e konsulencës së supervizionit për një periudhë katërvjeçare deri në fund të vitit 2016.

### Procedurat mjedisore

Në kuadrin e Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes së procedurave mjedisore siç parashikohen në Manualin e Procedurave, në kërkesat e programit dhe marrëveshjet me donatorët. Është ndjekur procesi i marrjes së lejes së mjedisit, që nga përgatitja e dokumentacionit përkatës, organizimi i konsultimit me publikun dhe aplikimi për leje për të gjitha rrugët e reja në kuadër të këtij programi. Njëkohësisht është kontrolluar zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe në rast mosplotësimi të kriterëve të vendosura, janë aplikuar penalitetet përkatëse.

### Funksionim – Mirëmbajtja dhe Ngritja e Kapaciteteve


FSHZH ka kryer transferimin e 51 rrugëve pranë ARRSH së bashku me rrugët dhe programin e planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve ROMAPS. Në të përfshihet informacioni për të gjitha rrugët e marra në dorëzim nga ARRSH. Pranë ARRSH-së, pas përfundimit do të kalojnë edhe rrugët që janë duke e rindërtuar. Dorëzimi i rrugëve të përfunduara është shoqëruar edhe me Sistemin e Menaxhimit të Aseteve të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, sistem i cili lejon ARRSH-në të kryejë planifikimin dhe buxhetimin e mirëmbajtjes së tyre. Ndërkohë pranë NJQV-ve janë dorëzuar 18 segmente rrugore lokale. Që nga fillimi i zbatimit të programit janë kryer dy cikle trajnimesh për NJQV-të në të gjithë vendin, lidhur me funksionim dhe mirëmbajtjen e rrugëve të rikonstruara në kuadër të PRDL.

Në këtë kuadër FSHZH është duke u zbatuar programi *Mbështetja e Zhvillimit të një Sistemi të Qëndrueshëm të Mirëmbajtjes së Rrugëve në Qeverisjen Lokale* financuar nga BEI (Banka Europiane e Investimeve), i cili filloi zbatimin në fillim të vitit 2014 dhe ka një kohëzgjatje prej 14 muaj. Fokusi i Programit të Mirëmbajtjes së rrugëve lokale dhe rajonale është përmirësimi i gjendjes së rrugëve lokale, *nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike për njësitë vendore duke përmirësuar kapacitetet e tyre në mirëmbajtjen e rrugëve lokale*. Problemi kryesor që adreson programi lidhet me mirëmbajtjen e pamjaftueshme të rrjetit rrugor në vendin tonë. Programi synon të arrijë ndërtimin e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese në mirëmbajtjen e rrugëve në nivelin lokal.

**Komponenti i dytë – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale dhe lokale.**

### Rrugët e financuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Europiane e Investimeve (EIB), IPA 2010 - 2011

EBRD, EIB, IPA 2010 - 2011 kanë financuar këtë program me 138.5 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një financim i vetëm. Deri në Dhjetor 2014 me këto fonde janë financuar 58 segmente rrugore në një gjatësi prej 534 km.



Deri në Dhjetor 2014 kanë përfunduar punimet në 44 akse rrugore me një gjatësi prej 400 km. Vijnë punimet në 12 segmente rrugore me një gjatësi prej 117.46 km. Ndërkohë në fazën e tenderimit është segmenti rrugor Qafë Shper – Ura e Kudhës. Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit është “Ndërtimi i Shëtitorës në bregdetin e Vlorës – Lungo Mare, e cila parashikohet të financohet nga IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare.

Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qenë pozitive dhe mund të thuhet se standardet e reja të aplikuar në këtë projekt po japin rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve. *(Aneks 7.2 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga EBRD, EIB, IPA 2010- 2011 (Dhjetor 2014)*

**Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009**

KfW dhe IPA 2009 kanë financuar këtë program përkatësisht me 15 dhe 8.8 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një i vetëm. Me këto fonde parashikohet financimi i rreth 90 km rrugë në Qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër. Aktualisht kanë përfunduar projektet teknike për të gjitha segmentet rrugore të parashikuara për financim, dhe procesi i konsultimit me publikun. Në Dhjetor 2014 kanë përfunduar punimet për segmentin rrugor Ruga nacionale – Qelëz 12.8 km. Janë në proces zbatimi 5 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 61.5 km. Ndërkohë është në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik segmenti Tamarë- Vermosh Loti 2 me gjatësi 14,39 km.



*(Aneks 7.3 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga KfW & IPA 2009 (Dhjetor 2014)*

**Rrugët e financuara nga OFID I & II**

Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) ka financuar programin në dy faza në një total prej 25 milionë USD. Deri në fund të muajit Dhjetor 2014 nga ky donator janë financuar 17 segmente rrugore dhe 5 ura, në një gjatësi totale prej 115 km. Nga këto 16 segmente rrugore dhe 5 ura ose 104.8 km kanë përfunduar punimet civile. Rrugët e përfunduara gjenden në Qarqet Berat, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Korçë, Lezhë, Shkodër, dhe Vlorë. Grafiku iu referohet segmenteve rrugore të cilat kanë përfunduar punimet civile dhe atyre që janë në proces zbatimi.

Ndërkohë vijnë punimet në segmentin rrugor Thumane – Lac 10.5 km i gjate, financuar nga OFID II. Njëkohësisht kanë përfunduar punimet në 2 ura, pjesë e trashëgimisë historike në bashkinë e Beratit, ura e Goricës dhe ura e Velabishtit.

*Aneks 7.4 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID I & II (Dhjetor 2014)*




## Rrugët e financuara nga Banka Islamike për Zhvillim dhe Qeveria Shqiptare (IDB & GoA)

Banka Islamike për Zhvillim ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale” në shumën prej 40 milionë USD. Këtij financimi i është shtuar dhe një kontribut i Qeverisë Shqiptare në vlerën 4 milionë USD.

Deri në Dhjetor 2014, janë financuar 13 segmente rrugore ose 101 km. Nga këto kanë përfunduar punimet civile për 12 segmente rrugore në një gjatësi prej 99.05 km. Në proces zbatimi është 1 segment rrugor me gjatësi prej 2.1 km. Kanë përfunduar punimet në akset rrugore: Kam – Golaj, Ura e Mesit – Prekal, Ura Gjadër – Mnelë, Fshat i Ri – Kukël, Sheshi i trageteve – Lekbibaj, Kukës – Shishtavec Lot 2, Ura Dushaj – Sheshi i Trageteve, Sopot – Kërnajë, Tropojë – Bucaj, Ura Shulbatër – Gurrë e Vogël Lot 1, Peshkopi – Ushtelenxë dhe Rruga Nacionale – Dajç. Punimet vijojnë në segmentin Kodër Marlekaj në Bashkinë Lezhë. Në fund të këtij viti rezultojnë se falë kursimeve dhe përdorimit të kujdesshëm të fondeve rezervë, kanë mbetur ende fonde të cilat po rialokohen për financimin e disa projekteve të vogla lokale.

*Aneks 7.5 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga IDB & GoA (Dhjetor 2014)*



## Rrugët e financuara nga Banka e Këshillit të Europës (CEB)


Banka e Këshillit të Europës (CEB) ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” me 40 milionë Euro. Me këto fonde deri në fund të muajit Qershor 2014 që shënon dhe mbylljen përfundimtare të këtij financimi, janë rindertuar 32 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 249 km. Punimet civile kanë përfunduar në të gjitha rrugët e financuara nga ky donator.

Grafiku iu referohet 32 segmenteve të financuara deri në Qershor 2014 nga Banka e Këshillit të Europës.

Rrugët e përfunduara janë vënë në funksionim të plotë. Muaji Qershor

2014, shënoi mbylljen përfundimtare të këtij projekti në përputhje me marrëveshjen e financimit të CEB. Segmentet rrugore që kanë përfunduar periudhën e garancisë, janë mbyllur përfundimisht duke iu dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar ose NJQV-ve përkatëse.

*Aneks 7.6 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga CEB (Dhjetor 2014)*



## Konkluzione:

Programi ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të tij, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Vetëm gjatë vitit 2014 në kuadër të zbatimit këtij programi, FSHZH ka ndjekur zbatimin e 52 segmenteve rrugore dhe urave në një gjatësi prej 432 km. Që nga fillimi i zbatimit të PRDL deri në fund të vitit 2014 janë financuar rreth 1170 km rrugë dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, duke plotësuar objektivat dhe pritshmëritë e programit.

Ecuria e financimit ka treguar progres dhe rezulton që gjatë vitit 2014 kanë qënë në proces zbatimi 54.64 Milionë Euro.

Muaji Qershor 2014 shënoi përfundimin e plotë dhe me sukses të financimeve të CEB (Banka e Këshillit të Europës) në kuadër të projektit PRDL me një vlerë prej 40 milionë Euro.

Ndërkohë janë ende në zbatim financimet e EBRD, EIB, KfW, OFID, IDB dhe IPA 2009 – 2010 – 2011.

Performanca shumë e mirë e këtij programi është vlerësuar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat përmes misionëve dhe raporteve të ndryshme e kanë vlerësuar maksimalisht atë.

#### 4. Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale

Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim, KfW, dhe Bashkimi Europian. I ndarë në disa projekte të veçanta ky program përbën një nga iniciativat më serioze të këtyre viteve të fundit për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ky program ka arritur deri më sot një financim total prej 17.46 milionë Euro. Përmes këtyre programeve parashikohet të përfitojnë më shumë se 60,000 banorë në zonat rurale, duke mundësuar kështu furnizim me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër.

Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banorë)	Nr. i fshatrave
<b>RWSP I &amp; II</b>	2008-2014	11.66	Kukës, Dibër, Shkodër	40,000	53
<b>SIF IV</b>	2010-2016	5.8	Kukës, Dibër, Shkoder	20,000	23

#### 4.1 “Furnizimi me Ujë I Zonave Rurale I & II”

Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, financuar nga KfW, konsiston në ndërtimin e 29 skemave të ujësjellësive rurale në 53 fshatra në Qarqet Dibër, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së rreth 40.000 banorëve. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe ishte parashikuar të përfundonte në fund të vitit 2014. Ky afat do të zhvendoset në Qershor të vitit 2015 për shkak të rialokimit të fondeve rezervë të mbetura pa u harxhuar dhe dibursimit për pagesën e një kontrate për arsye objektive. Për këtë shtyrje të afatit pritet të merret edhe aprovimi i KfW. Vlera e programit është 11.66 milionë Euro, nga të cilat (7.5 milionë + 1.5 milionë) për masat investuese, 1 milionë Euro Grant për ngritje kapacitetesh, masat shoqëruese, dhe 1.66 milionë Euro kontribut i Qeverisë Shqiptare & përfituesve të drejtpërdrejtë).

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014, programi ka zhvilluar një aktivitet intensiv për mbylljen e kontratave të punimeve civile për 29 skemat skemat e ujësjellësive të financuar, ndjekjen e periudhës së garancisë dhe dorëzimin e tyre pranë NJQV-ve përfituese.


Ngritja e kapaciteve lokale lidhur me funksionim – mirëmbajtjen, administrimin e ujësjellësive, si dhe monitorimin dhe raportimin e performancës së Njërive të Furnizimit me Ujë të ngritura brenda komunave ka qënë gjithashtu pjesë e punës për këtë periudhë.

Në fund të vitit 2014, rezulton se punimet civile për ndërtimin e ujësjellësive kanë përfunduar në 10 kontrata që përfaqësojnë 29 skema ujësjellësive, duke mundësuar kështu furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër, për 53 fshatra në qarqet Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Ndërkohë punimet vijnë pjesërisht me riparime defektesh dhe punime të vogla për mbylljen e objekteve dhe dorëzimin përfundimtar të tyre. Për një skemë tjetër pritet financimi nga DPUK për linjën kryesore dhe është planifikuar që zbatimi i punimeve të kryhet gjatë programit SIF IV. Në këtë kuadër është vendosur, që fondet e planifikuara për implementimin e kësaj skeme, të kalojnë për financim e saj në programin SIF IV.

Me fondin rezervë të programit, janë hartuar fizibilitetet për ndërtimin e ujësjellësive të 5 fshatrave në komunat Postribë dhe Tropojë e Vjetër, në qarqet Shkodër dhe Kukës. Punimet kanë përfunduar edhe për këto skema ujësjellësive dhe muaji Gusht 2014 ka shënuar dorëzimin përfundimtar të këtyre objekteve pranë NJQV-ve përfituese.

**Aneks 7.7** Informacion mbi nënprojektet e programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, financuar nga KfW (Dhjetor 2014)



#### 4.2 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” , SIF IV

Në kuadër të programit SIF IV, financuar nga KfW në vlerën 5 milionë Euro dhe 0.8 milionë Euro të tjera që janë kontribut lokal nga NJQV-të përfituese synohet ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësive në Qarqet, Kukës, Shkodër dhe Dibër çka do të sigurojë furnizim me ujë higjienikisht të pastër rreth 20,000 banorë në zonat rurale. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2016.

Gjatë vitit 2014, programi i ri SIF IV shënon progres në të gjithë komponentët e tij. Ka përfunduar hartimi i fizibiliteteve dhe së bashku me donatorin në bazë të kriterëve përzgjedhëse, është kompletuar lista finale për financim. Kjo listë përmban 15 skema ujësjellësash të cilat përfshijnë 23 fshatra dhe janë përqëndruar në 11 komuna. Janë përgatitur Marrëveshjet Paraprake dhe Marrëveshjet Finale të Investimit me komunat përfituese, dhe u janë shpjeguar procedurat për pagesën e kontributit lokal. Aktualisht është mbledhur rreth 95 përqind e kontributit të këtyre skemave.

Pas përfundimit të projekteve teknike në Janar 2014, u shpall tenderi parakualifikues dhe në fund të Marsit 2014, tenderi për punimet civile në 15 skemat e përzgjedhura për financim.

Në Qershor 2014 u shpall kompania fituese dhe në fund të Muajit Qershor u lidh kontrata e zbatimit të projekteve për këto 15 rrjete ujësjellësash në Qarqet Dibër, Kukës, Shkodër. Në muajin Korrik 2014, kontraktori ka filluar zbatimin e punimeve. Puna vijon normalisht në 14 skema. Në skemën e Komunës Gurrë u konstatuan probleme thelbësore sociale. Pas shumë përpjekjeve së bashku me Komunën, nuk u arrit një zgjidhje. Kështu FSHZH, së bashku me Komunën dhe aprovimin e donatorit, mori vendim që në këtë skemë të mos ndërhyhet. Në vijim është propozuar dhe rënë dakord me KfW-në, që kjo skemë të zëvendësohet me skemën Bujan, Qarku Kukës, për të cilën fizibiliteti është aprovuar më parë nga KfW. Konsulenti “KOCKS” do të dorëzojë deri në fund të shkurtit 2015, projektin dhe raportin teknik. Në fund të Dhjetorit 2014, progresi fizik i llogaritur i projektit në tërësi është në masën 40 përqind.

*Aneks 7.8 Informacion mbi ujësjellesat e programit “SIF IV”, financuar nga KfW (Dhjetor 2014)*

#### Prokurimi

Gjatë vitit 2011, janë shpallur tenderat për punimet civile të 29 skemave të ujësjellësive të financuar në kuadër të këtij programi, dhe janë përzgjedhur fituesit për 10 lotet. Procedurat e prokurimit për punimet civile u kryen sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Për skemat shtesë, janë bërë shtesa kontrate për 4 kompani ekzistuese. Këto shtesa janë bërë duke respektuar përqindjet që lejon kontrata për kompanitë që ofertuan. Gjatë muajit Mars 2014, u shpall tenderi ndërkombëtar për zbatimin e punimeve civile për 15 skemat e përzgjedhura për investim të programit SIF IV sipas procedurave përkatëse.

#### Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Janë hartuar fizibilitetet mjedisore dhe Planet e Menaxhimit të Mjedisit për të gjitha skemat e ujësjellësive.
- Janë duke u ndjekur procedurat mjedisore dhe përgatitja e lejeve mjedisore për skemat e reja që u futen me fondet e Programit SIF IV.
- Gjatë vitit 2014, krahas përgatitjes së fizibiliteteve teknike dhe projekteve për skemat e përzgjedhura, vijon puna me procedurat për plotësimin me leje mjedisore si dhe lejen nga drejtorja e baseneve për përdorimin e burimeve ujore.

#### Konkluzione:



Programi RWS I & II është në fazën e mbylljes së kontratave dhe dorëzimit të tyre pranë NJQV-ve përfituese. 29 skemat e financuara kanë përfunduar punimet civile. 22 skema kanë përfunduar periudhën e garancisë dhe janë dorëzuar pranë NJQV-ve përfituese.

7 skema janë ende në periudhë garancie dhe do të dorëzohen pranë NJQV-ve përfituese brenda vitit 2015.

Ecuria e projektit si në zbatimin e punimeve ashtu edhe në zbatimin e masave shoqëruese shfaqet e kënaqshme. Menaxhimi profesional dhe zbatimi i kënaqshëm i këtij programi, ka rezultuar me përfitimin e një financimi të dytë nga ana e KfW-së përmes Programit SIF IV, në vlerën prej 5.8 milionë Euro, përmes të cilit po financohen 15 skema të reja ujësjellësash. Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellësa, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat do të përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësave Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi European përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro.

## 5. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

### 5.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2014, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë këtij viti, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar i tij të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe Programit të Ujësjellësave Ruralë, buxheti fillestar për vitin 2014, i miratuar për FSHZH ishte në vlerën 7,726 milionë lekë. Gjatë vitit 2014, buxheti i FSHZH është shtuar në kategorinë investime nëpërmjet dy akteve normative me një vlerë prej 2,584 milionë lekë, duke arritur në vlerën 10,310 milionë lekë ose rreth 73.9 milionë Euro.

Gjatë vitit 2014 ky buxhet i rishikuar është realizuar në masën 99.3% ose rreth 73.3 milionë Euro.

Gjithashtu gjatë vitit 2014, si rezultat i vendimit të Qeverisë Shqiptare për përfshirjen e FSHZH si autoritet kontraktues në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, nëpërmjet vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve janë akorduar rreth 1,418 milionë lekë për investime në infrastrukturën vendore. Duke marrë parasysh që shumica e fondeve u akorduan në katërmujorin e fundit 2014, koha në dispozicion për kontrollin dhe standartizimin e projekteve, pajisjen me lejet mjedisore, procedurat e prokurimit, lidhjen e kontratave dhe fillimin e punimeve ishte shumë e kufizuar.

Si rezultat i këtyre vështirësive, ky buxhet u realizua në vlerën 365.3 milionë lekë ose masën 25.8% kundrejt fondit të akorduar për vitin 2014.

Sa më sipër, buxheti i vitit 2014 është realizuar në vlerën rreth 75.87 milionë euro ose 90% kundrejt buxhetit të rishikuar.

Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna progresive vjetore të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomik - financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së gjatë këtij viti, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si dhe peshën specifike të donatoreve, kategorive dhe komponentëve të veçantë.

Në tremujorin e parë 2014 janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2013 (Bilanci) dhe në 15.03.2014 janë dërguar në Ministrinë e Financës sipas formatit dhe standarteve të kërkuara.

Gjithashtu në periudhën Gusht – 10 Tetor 2014 është kryer Auditimi i Jashtëm i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2013 nga kompania audituese KPMG, e përzgjedhur nga Ministria e Financës. Për vitin 2013 janë çertifikuar gjithsej 4 raporte:

- raporti për Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale;
- raporti për Programin e Ujësjellësave Rurale;
- raporti i FSHZH si njësi;
- raporti i konsoliduar i gjithë aktivitetit institucional.

Raportet me pasqyrat financiare të çertifikuara janë dërguar tek donatorët respektivë.

### **Të ardhurat e FSHZH-së**

Gjatë vitit 2014 FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare që rrjedhin nga marrëveshjet qeveritare në kuadër të 2 Programeve në zbatim dhe në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” – financuar Banka Botërore, OFID,CEB,IDB, ISTISNA, EIB, EBRD,IPA 2010-2011, KfW & IPA 2009 dhe Qeveria Shqiptare ;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” – financuar nga KfW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;

### **Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2014 sipas Programeve**

■

Gjatë këtij viti, në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 55.28 Milionë Euro sipas Programeve si më poshtë:

- Për Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale gjatë këtij viti janë disbursuar rreth 54,52 milionë Euro nga të cilat OPEC në vlerën 1.9 milionë Euro, IDB & ISTISNA në vlerën 2.2 milionë Euro, KfW SIF IV & IPA 2009 në vlerën 4.38 milionë Euro, BERZH në vlerën 20.11 milionë Euro BEI 7 milion Euro dhe IPA 2010-2011 në vlerën 17.95 milionë Euro, BERZH Grant 976 mijë Euro;
- Për Programin e Ujësjesave Ruralë gjatë këtij viti janë disbursuar 768 mijë Euro.

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare për vitin 2014 për të dy programet në vazhdim, në komponentët Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën 14.94 milionë Euro.

Fondet e akorduara në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore gjatë vitit 2014 janë në vlerën 11.39 milionë Euro.

Gjithashtu gjatë këtij viti, në kuadër të Programit të Ujësjesave Ruralë janë arkëtuar direkt nga përfituesit lokale rreth 239 mijë Euro si kontribut i tyre në bashkëfinancimin e nënprojekteve.

### **Të ardhura të tjera**


Gjatë aktivitetit ekonomik-financiar të saj, FSHZH realizon të ardhura në vlera monetare nga aktivitetet dytësore dhe nga marrëveshjet e drejtpërdrejta me donatorë të ndryshëm.

Gjatë këtij viti janë arkëtuar të ardhura nga aktiviteti dytësor dhe nga donatorët e huaj si më poshtë:

- Të ardhura të tjera nga garancitë bankare dhe shitja e dokumentave për tendera në vlerën 76 mijë Euro.
- Për Programet IPATECH, IPA Monteval dhe IPA Hera janë disbursuar 296 mijë Euro ne përputhje me kërkesat për financime për secilin program.

## Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2014

Gjatë këtij viti FSHZH ka menaxhuar një fond prej 75.87 milionë Euro, me një realizim financiar në masën 90 % të buxhetit vjetor 2014 të ndryshuar. Realizimi financiar paraqitet më poshtë i ndarë sipas komponentëve:



### Infrastruktura

Ky zë përbën aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për punime civile për rikonstruksion dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore, gjelbërim të infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera, rehabilitim të zonave urbane, rehabilitim dhe ndërtim të ujësjesave ruralë, restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe të tjera. Në këtë komponent është ndjekur zbatimi i punimeve dhe i periudhës së garancisë si dhe janë financuar 107 kontrata punimesh civile. Si komponent është realizuar në vlerën rreth 71,45 milionë Euro ose në masën prej 91% kundrejt buxhetit vjetor (të ndryshuar). (Tabela bashkëngjitur "Realizimi i zërave të Buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2014").

### Realizimi financiar për periudhën Janar – Dhjetor 2014 për kategorinë "Investime"

Programet	Pesha specifike në % kundrejt realizimit vjetor 2014	Realizimi në vlerë (shprehur në Euro)
Programi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale (CEB, OPEC I & II, EIB & EBRD, IPA 2010-2011, IDB-ISTISNA, KfW, IPA 2009)	76 %	54,645,949
Programi i Ujesjellesave Rurale (KfW/SIF IV)	1 %	885,157
Investime Qeveria Shqiptare +TVSH +FZHR	22 %	15,371,756
Përfituesit+Fondet e FSHZH	1 %	550,372
<b>Totali</b>	<b>100 %</b>	<b>71,453,234</b>

### Projektim – Supervizimi

Për këtë vit, ky zë është realizuar në vlerën rreth 2,335 mijë Euro ose 87% kundrejt buxhetit vjetor dhe përfshin shpenzime për projektim dhe supervizion të punimeve civile sipas programeve përkatëse. Në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale janë disbursuar rreth 1,339 mijë Euro për financimin e kontratës së supervizionit me kompaninë IRD Engineering, në kuadër të Programit të Ujësllësave Ruralë janë disbursuar rreth 388 mijë Euro për financimin e kontratës së supervizionit me kompaninë Kocks Consult GMBH. Në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve janë disbursuar rreth 497 mijë Euro për financimin e projektit final për Vijën Bregdetare të Vlorës (Lungomare) për kontratën me kompaninë XDGA, rreth 14 mijë Euro për hartimin e projekt-idesë për Lungomare dhe shpalljen e projekteve për vitalizimin e qyteteve dhe rajoneve dhe supervizion për ujësllësë rurale. Në kuadër të projekteve IPA janë disbursuar rreth 48 mijë Euro për financimin e projekt-idesë të restaurimit të fototekës Marubi dhe supervizion për punimet për infrastrukturën turistike të zonës së Alpeve. Gjithashtu, nga fondet e vetë institucionit janë disbursuar rreth 49 mijë Euro për financimin e aktiviteteve të organizuara për shpalljen e projekteve për vitalizimin e qyteteve dhe rajoneve dhe shpalljen e projekt-ideve për Vijën bregdetare të Vlorës (Lungomare).

### Asistenca Teknike

Ky komponent është realizuar në vlerën 742 mijë Euro ose në masën 64% kundrejt Buxhetit vjetor. Ky zë përfshin asistencë teknike të huaj për menaxhimin e kontratave të punimeve, ndjekjes së procedurave të prokurimeve sipas standarteve të çdo donatori dhe mirëmbajtjes rrugore në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale në vlerën 468 mijë Euro, asistencë teknike e huaj në kuadër të Programit të Ujësllësave Ruralë rreth 199 mijë Euro, konsulencë lokale në kuadër të mbështetjes institucionale, strategjise së zhvillimit rajonal dhe informim-komunikimit në vlerën 75 mijë Euro të financuara nga projektet IPA dhe CEB Grant.

### Kualifikime

Ky komponent përfshin shpenzimet e bëra për kualifikimin e stafit të FSHZH-së dhe të komunave dhe bashkive. Ky zë është realizuar në vlerën 29 mijë Euro ose në masën 22 % kundrejt buxhetit vjetor, nga të cilat rreth 7 mijë euro janë shpenzuar në kuadër të projekteve IPA për aktivitete të ndryshme, për promovimin e vlerave të zonave turistike dhe për kualifikime me temë “Zhvillimi ekonomik lokal” për stafet e komunave dhe bashkive, si dhe aktivitete të ndryshme për FSHZH dhe 22 mijë Euro për trajnimet me temë “Funksionimi dhe Mirëmbajtja” në kuadër të Projektit “Furnizimit me Ujë i Zonave Rurale” financiar nga KfW.

### Shpenzime operative

Shpenzimet operative gjatë vitit 2014 janë realizuar në vlerën 178 milionë Lekë ose rreth 83% kundrejt buxhetit vjetor 2014.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të nënkomponentëve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

#### Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2014 Analiza e shpenzimeve të kostos operative

REALIZIMI KUNDREJT BUXHETIT 2014 (Kosto operacionale) Lekë				
Nr.	ZËRAT	BUXHET 2014	REALIZIMI VJETOR 2014	PËRQINDJA E REALIZIMIT
1	Kanceleri	3,000,000	2,566,109	85.5%
2	Karburant	13,000,000	10,915,059	84.0%

3	Servis makinash/siguracion	7,500,000	7,031,010	93.7%
4	Pagat	159,632,000	140,445,852	88.0%
5	Dieta	5,750,000	4,127,387	71.8%
6	Telefon dhe PT	3,500,000	2,297,132	65.6%
7	Internet	1,300,000	612,335	47.1%
8	Energji Elektrike/Uje	2,500,000	1,478,801	59.2%
9	Zyra me qera	2,500,000	1,127,992	45.1%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	3,900,000	1,660,233	42.6%
11	Te tjera/Petty cash	5,630,000	2,696,769	47.9%
12	Publikimi & Promovime	6,000,000	2,998,185	50.0%
13	Shpenzime gjyqesore/Perkthime/Kontrata Sherbimi	870,000	562,115	64.6%
14	Servis kompjuter dhe fotokopje	550,000	258,472	47.0%
	<b>TOTAL</b>	<b>215,632,000</b>	<b>178,777,451</b>	<b>83%</b>

#### a. Shpenzimet për kancelari

Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj. Gjatë këtij viti janë shpenzuar rreth 2.56 milionë Lekë ose në masën 85.50% të buxhetit vjetor.

#### b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 13 milionë Lekë. Gjatë këtij viti, shpenzimi i kryer është në vlerën 10.91 milionë Lekë dhe përfaqëson shpenzime për blerje karburanti në mbështetje të mbikqyrjes në terren të punimeve, kryesisht për Departamentin e Infrastrukturës.

#### c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 7.5 milionë Lekë. Realizimi për këtë viti është rreth 7 milionë Lekë ose në masën 93.70% të buxhetit vjetor.

#### d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2014 janë parashikuar në shumën 159 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masën 88% kundrejt buxhetit vjetor.

#### e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2014 janë parashikuar në shumën 5.75 milionë Lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 4.12 milionë Lekë ose 71.80% kundrejt buxhetit vjetor dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren.

#### f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3.5 milionë Lekë dhe është realizuar në vlerën 2.29 milionë Lekë ose 65.60% kundrejt buxhetit vjetor.

#### g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, servis kompjuteri dhe fotokopje, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qëndrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në Buxhetin 2014 janë parashikuar rreth 15.83 milionë Lekë nga të cilat rreth 5.63 milionë Lekë do financohen nga fondet e vete institucionit. Ky zë është realizuar në vlerën 7.57 milionë Lekë ose 48% kundrejt buxhetit vjetor.

#### h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Në buxhetin e vitit 2014 për këtë zë janë parashikuar rreth 6 milione Lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar shpenzime në masën 3 milionë lekë.

#### i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore, përkthime, noterizime

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2014 janë parashikuar rreth 870 mijë Lekë. Gjatë këtij viti shpenzimet për këtë zë janë në vlerën 562 mijë lekë.

#### j. Servis kompjuter dhe fotokopje.

Në buxhetin e vitit 2014 për këtë zë janë parashikuar rreth 550 mijë Lekë dhe realizimi është në vlerën 258 mijë Lekë ose rreth 47% kundrejt buxhetit vjetor.

## 5.2 Komunikimi dhe Informimi

Komunikimi dhe Informimi është një aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Arritjet e deritanishme të FSHZH-së, dhe veçanërisht intensiteti i lartë i projekteve dhe investimeve për këtë periudhë nëpërmjet një strategjie komunikimi të mirëpërcaktuar i janë komunikuar një publiku më të gjerë.

Gjatë vitit 2014, krahas aktiviteteve promovuese dhe informuese mbi Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe Programin e Ujësjiellësave Rural, FSHZH ka ndërmarrë një fushatë të gjerë informuese mbi prezantimin e projekteve MONTEAL, IPATECH agrobiznes, projekti HERA: "Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë së vendeve të rajonit të Adriatikut" si dhe investimet e kryera nga FSHZH me financim të Qeverisë Shqiptare nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR). Me qëllim rritjen e vizibilitetit të këtyre projekteve është mundësuar edhe pjesmarrja në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë vazhdë, ka qenë edhe kontributi i sektorit të informim-komunikimit në procesin e përgatitjes dhe aplikimit të Studimit të Fizibilitetit për Projektin e Rikonstruksionit të Lumit të Vlorës pranë Fondit Kuvaitian për Zhvillimin Ekonomik Arab.

Gjithashtu në zbatim të Strategjisë së Komunikimit në lidhje me promovimin e aktiviteteve të FSHZH-së është kryer edhe publikimi i broshurës së përditësuar institucionale si dhe printimi i një serie materialesh të tjera informuese si fletëpalosje, banera, postera si dhe kartolina e kalendari i fundvitit.

Informimi i publikut është realizuar në këto drejtime:

- **Mediat vizive**

Aktiviteti i FSHZH ka qenë prezent në median vizive nëpërmjet pasqyrimin të kronikave për Projektin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale, Projektin HERA, MONTEAL, IPATECH si dhe projektet e reja që po zbatohen nga FSHZH me financim nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Gjatë kësaj periudhe janë transmetuar rreth 50 kronika mbi aktivitetet e FSHZH-së në televizionet kombëtare si Top Channel, Klan TV, ABC Neës, Ora Neës, A1 Report TV; ndërsa Televizioni Publik Shqiptar ka pasqyruar gjatë tremujorit të fundit të 2014, një cikël prej 10 kronikash mbi investimet e FSHZH-së në Vermosh, Shishtavec të Kukësit, Valbonë të Tropojës, Dumre të Elbasanit, Rrëshen e Burrel të rrethit të Matit, investimin për aksin e Rrugës së Elbasanit, investimet në Surrel të Komunës Dajt, investimin në rrugën e Senatoriumit, dhe urën dhe investimet në qytetin e Beratit.

- **Shtypi i shkruar**

Përveç mbulimit televiziv të aktivitetit, paralelisht është bërë edhe pasqyrimi i aktivitetit të FSHZH-së në shtypin e shkruar. Vëmendje i është kushtuar nga media e shkruar projekteve të reja që po implementohen nga FSHZH në kuadër të investimeve nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve pasi këto investime fokusohen në rivitalizimin e qendrave urbane. Artikuj mbi investimet e FSHZH-së janë pasqyruar në revista, gazeta, si dhe media elektronike si p.sh., gazeta Panorama, gazeta Standart, Shqiptarja.com, Shekulli, Balkanweb, gazeta Dita, etj. Gjatë kësaj periudhe janë pasqyruar edhe tre intervista të Drejtorit Ekzekutiv, respektivisht në gazetën Telegraf, Dita dhe Agjencinë Telegrafike Shqiptare.

- **Faqja zyrtare e web-it**

I gjithë aktiviteti në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe në faqen zyrtare të web-it të FSHZH në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Gjatë kësaj periudhe është krijuar edhe një ndërfaqe e re në faqen zyrtare të FSHZH-së mbi Projektet e Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut; faqe e cila është edhe në gjuhën angleze. Gjatë kësaj periudhe janë pasqyruar rreth 48 lajme në gjuhën shqipe dhe 28 në gjuhën angleze. Është bërë përditësimi i vazhdueshëm i informacionit si pasqyrimi i përshtimeve në shqip dhe anglisht të projekteve të reja në zbatim.

- **Faqja zyrtare Facebook**

I gjithë aktiviteti i FSHZH në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe e video dhe në faqen zyrtare të Facebook-ut. Në këtë faqe përveç publikimeve të aktiviteteve të FSHZH është bërë një komunikim interaktiv i personave të interesuar jo vetëm me postime në murin e kësaj faqeje, por dhe me komente të ndryshme të investimeve të kryera si dhe atyre të reja. Gjatë kësaj periudhe FB është pasuruar me rreth 80 postime të reja. Numri i ndjekësve të FB ka ardhur duke u rritur, çka shpjegohet me pasqyrimin e aktiviteteve që kanë një interes të madh publik si “Dëgjesa Publike” për prezantimin e projektit fitues për Restaurimin dhe Muzealizimin e Fototekës Kombëtare Marubi, “Logu i Bjeshkëve”, “Prezantimi i Projektit të Lungomares”, Vizita e Kryeministrit në Komunën e Kelmendit për të inspektuar rikonstruksionin e rrugës “Tamarë-Vermosh” etj.

### 5.3 Monitorimi dhe Vlerësimi

Gjatë vitit 2014, ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së programeve kryesore në zbatim nga FSHZH.



Monitorimi i ecurisë së Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale në të gjithë elementet e tij, ka qënë një ndër aktivitetet parësore të sektorit të Monitorim – Vlerësimit. Puna për monitorimin e programit ka konsistuar në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi ecurinë e nënprojekteve për të gjitha fazat e investimit dhe të gjithë Donatorët. Është bërë monitorimi i indikatorëve të ecurisë së projektit, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar.

Në kuadër të monitorimit të këtij programi, janë përgatitur raporte të monitorimit të programit. Me kërkesë të donatorëve që kanë financuar këtë program janë dërguar informacione që lidhen me ecurinë dhe indikatorët e performancës. Gjatë kësaj periudhe është punuar për hartimin e metodologjisë për realizimin e raportit të vlerësimit të përfituesve për rrugët e financuara nga IDB. Aktualisht është mbyllur financimi i programit nga Banka Botërore. Në raportin përfundimtar të Bankës Botërore dhe OFID I, *Implementation Completion Report* (ICR), ka vlerësuar këtë program si shumë të suksesshëm.

30 Qershori 2014, shënoi përfundimin me sukses të projektit për pjesën e financuar nga Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB) në vlerën 40 Milionë Euro (kredi) dhe 180 mijë Euro (grant) nga Norway Trust Account. Aktualisht është duke u hartuar raporti përfundimtar i projektit për këtë donator.

Ndërkohë në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale”, u realizua një studim mbi vlerësimin e ndërhyrjes në disa raste studimi për rrugët dytësore dhe lokale të financuara në kuadër të PRDL dhe PK III. Në këtë studim u përzgjedhën disa tipe rrugësh si më poshtë:

- Rrugë që kanë nxitur zhvillimin ekonomik në zona me dendësi të madhe të popullsisë dhe prodhimitari të lartë bujqësore dhe blegtorale;
- Rrugë që kanë nxjerrë nga izolimi zona banimi të largëta dhe kanë lidhur zona të ndryshme të vendit me rrugë rajonale;
- Rrugë që kanë rritur aksesin drejt zonave turistike; etj.

Rezultatet e këtij vlerësimi janë mjaft pozitive dhe inkurajuese. Ato janë përmbledhur në një raport i cili është në dispozicion për të gjithë të interesuarit që nga muaji Korrik 2014.

Në fund të këtij viti, vërehet një performancë shumë e mirë e programit në të gjithë elementët e tij.

**Monitorimi i Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”** ka ndjekur treguesit periodikë të komponentëve kryesorë të tij duke i krahasuar me planet e punës, dhe ka vërejtur përgjithësisht një ecuri të mirë të këtij programi. Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në monitorimin e indikatorëve bazë të programit, deri në këtë fazë të zbatimit të tij. Deri në fund të vitit konstatohet se programi paraqet performancë pozitive.

#### 5.4 Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka zhvilluar aktivitetin bazuar në planin vjetor të auditimit të miratuar në Këshillin Drejtues, në programet e aprovuara për çdo mision auditimi si dhe standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2014, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar 7 misione auditimi, 2 shërbime konsulence (një analizë dhe vlerësim situatë i kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv) dhe 5 raportime mbi zbatimin e rekomandimeve, nga 4 të parashikuara.

Janë përfshirë në proces auditimi: *rreth 242,7 milion \$ të kontaktuar, nga të cilët janë testuar në dokumentacion dhe terren 71,9 milion \$ fonde, janë testuar dhe verifikuar në terren 38 nënprojekte (rrugë dhe ujësjellës), 224,7 km rrugë dhe janë përfshirë në auditim të gjitha strukturat menaxhuese të FSHZH.*

Nga analiza e plotë e bërë në dokumentacionin teknik dhe financiar të objekteve, nga kontrolli i ushtruar në terren për çdo objekt të përfshirë në auditim si dhe nga verifikimi i

raportimeve drejtuar QSH dhe donatorëve bashkëfinancues, auditimi i brendshëm ka konstatuar se në përgjithësi sistemet e ngritura për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projekt/programave funksionojnë me efikasitet, duke siguruar kontroll të plotë dhe arritjen e objektivave të parashikuara. Në misionet e auditimit, gjithashtu janë konstatuar mangësi apo pamjaftueshmëri të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm në disa pjesë të veçanta të tij, për të cilat AB ka vlerësuar riskun dhe impaktin e tyre në arritjen e objektivave. Në mënyrë të përmblodhur, konstatimet sipas fazave të ciklit të projekteve janë:

- Në vlerësimin e fazës së projektimit, konstatohen projekte me mangësi në standartet e projektimit apo pasaktësime teknike. Veçanërisht, për projektet teknike të infrastrukturës vendore, të aplikuara në kuadër të FZHR, një pjesë e konsiderueshme është jashtë standardeve teknike të kërkuara dhe shpesh mungon koha e nevojshme për ripunimin e plotë të tyre. Mungesa e standardeve të projekteve teknike vlerësohet të këtë një risk të lartë për koston dhe cilësinë e nënprojekteve, duke kompromentuar kështu gjithë procesin e fazës së zbatimit. Në lidhje me këto problematika, AB rekomandon përgatitjen e projekteve në kohën e duhur dhe mundësisht nga studio projektimi me kapacitete profesionale të kompletuar (specialist mjedisi, specialist për studime gjeologjike), për të garantuar standartet e kërkuara të projektimit.
- Sistemi i prokurimit i vendosur, kryesisht garanton zbatimin korrekt të parimeve dhe procedurave të prokurimit si dhe një ulje mesatarisht rreth 26% nga kosto e paravlerësuar e nënprojekteve. Procesi monitorohet dhe kontrollohet hap pas hapi nga donatorët, duke dhënë garancitë e duhura për këtë proces. Megjithatë, vlerësohet si risk i pashmangshëm i këtij sistemi, kontraktimi i firmave sipërmarrëse të cilat nuk performojnë në nivele të kënaqshme (veçanërisht kur janë J&V). Gjithashtu, edhe rastet e nënkontraktimeve të punimeve në të zezë, megjithëse monitorohen dhe mbahen nën kontroll, mbeten një risk i vazhdueshëm, i cili duhet të menaxhohet rast pas rasti. AB lidhur me këto risqe ka rekomanduar forcimin e mbikëqyrjes së projekt/programave.
- Konstatohen vonesa në nxjerrjen e lejeve të ndërtimit për nënprojektet e reja, si dhe probleme sociale apo pronësi të paidentifikuara në fazat paraprake, të cilat riskojnë vonesa në fazat e mëtejshme të realizimit të nënprojektit. Rekomandimi i AB lidhur me këtë fenomen ka qënë forcimi i procedurave dhe rritja e bashkëpunimit me NJQV-të.
- Sistemi i mbikëqyrjes së punimeve civile duke qënë se menaxhon edhe risqet e mbartura nga dy fazat e para, është sistemi më i kontrolluar dhe monitoruar, megjithatë konstatohen mangësi që lidhen me standartet e pretenduara të punimeve në rrugë apo ujësjellës. Konkretisht konstatohen: vonesa në grafikët e punimeve në terren; raste të përdorimit të materialeve jo në cilësinë e kërkuar të projektit teknik apo moszbatim i standardeve teknike gjatë punimeve, të cilat riskojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimit. Vërehen raste të moszbatimit të standardeve për menaxhimin e trafikut gjatë punimeve duke riskuar sigurinë rrugore. Rekomandimet e AB, kryesisht, kanë synuar në përsëritjen e punimeve jashtë standardeve, në penalizimin e kontraktorëve, si dhe në rritjen e përformacës së kompanisë supervizuese. Vlera e dëmeve të llogaritur apo punimeve të cilat janë përsëritur apo kthyer vlerësohet të jetë 4.86 milion lekë ose 0.068% e fondeve të testuara.
- Nga auditimi i fazës së mirëmbajtjes së objekteve të përfunduara konstatohen probleme të cilat riskojnë mjaft qëndrueshmërinë e investimit të kryer. Lidhur me rrugët dytësore, të investura me PRDL është siguruar një zgjidhje procedurale, duke ia kaluar ARRSh në mirëmbajtje, ndërsa për rrugët lokale të cilat janë në pronësi të NJQV-ve, mbeten problemet e konstatuara edhe më herët, të cilat lidhen me kapacitetet e munguara financiare dhe profesionale të tyre në këtë proces. I njëjti fenomen konstatohet edhe me mirëmbajtjen e ujësjellësve të cilët jo vetëm duhet të mirëmbahen por edhe të operohet me sistemin e investuar. Trajnimet e realizuara në kuadër të projekteve, për të siguruar rritjen e kapaciteteve menaxhuese të tyre shpesh kanë rezultuar joefektive, kjo për arsye të ndryshme, si p.sh. ndryshimi i stafit të trajnuar apo mosarkëtimi i tarifave të vendosura, etj.

Për të gjitha mangësitë dhe gjetjet e auditimit, gjatë vitit janë dhënë rekomandimet përkatëse (në total 59), të cilat janë aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe janë mbështetur me urdhra të brendshëm që garantojnë zbatimin e rekomandimeve për secilin auditim.

Gjatë vitit janë përpiluar 5 raporte auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve, në të cilat është konstatuar impenjim i plotë i strukturave për korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe konsolidimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Është konstatuar se nga rekomandimet e dhëna, 60 % e tyre janë realizuar dhe 40 % janë në proces realizimi.

### 5.5 Misione të Donatoreve

- **Mision i Bankës Europiane të Investimeve (EIB) në kuadër të projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.**

Një mision i Bankës Europiane të Investimeve (EIB), vizitoi Shqipërinë në muajin Korrik 2014, për të diskutuar dhe vlerësuar ecurinë e projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”. Gjatë këtij misioni monitorimi u diskutua lidhur me një sërë çështjesh thelbësore si:

- Ecuria e punimeve civile e rrugëve të financuara;
- Mbikqyrja e punimeve nga supervizori;
- Asistenca teknike;
- Financimi, niveli i disbursimit dhe kostot;
- Raportimi, etj

Njëkohësisht u zhvilluan disa vizitë në terren për të parë nga afër ecurinë punimeve dhe për të diskutuar çështje teknike të zbatimit të projektit. Në përfundim të vizitës së tij Shqipëri, misioni i EIB vlerësoi se projekti vijon të ketë progres të mirë gjatë zbatimit të tij. Ai parashikohet të perfundojë në kohë duke realizuar buxhetin e akorduar dhe me një rezultat plotësisht të kënaqshëm.

- **Misione të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) në kuadër të projekteve RWS I, II, III dhe SIF IV, për komponentin e Ujësjetësive Ruralë dhe komponentin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale.**

- Misioni i parë është kryer gjatë periudhës nga 8 – 10 Maj 2014;
- Misioni i dytë është kryer gjatë periudhës nga 13 – 17 Tetor 2014;

Qëllimi i këtyre misioneve ka qënë vlerësimi i ecurisë së projekteve të financuara në kuadër të Programit të Ujësjetësive Rurale RWSP I & II. Pjesë e misionit ka qënë edhe zhvillimi i negociatave për financimin e fazës së tretë të programit. Ndërkohë në kuadër të financimit të SIF IV është diskutuar edhe ecuria e këtij projekti për të dy komponentët e tij: komponenti i ujësjetësive dhe komponenti i rrugëve dytësore dhe lokale. Gjatë këtyre misioneve janë organizuar takime me FSHZH dhe aktorë të tjerë të përfshirë në zbatimin e këtyre projekteve. Janë organizuar edhe vizita në terren për të parë nga afër ecurinë dhe cilësinë punimeve civile të kryera si në ujësjetësia ashtu edhe në rrugët e financuara.

Misionet në fjalë vlerësuan ecurinë pozitive të projekteve të financuara dhe punën e mirë që është kryer deri më sot për realizimin me sukses të tyre. Njëkohësisht u lanë disa rekomandime të karakterit teknik të cilat do të çojnë në rritjen e performancës dhe realizimin me sukses të financimeve si në komponentin e rrugëve ashtu edhe atë të ujësjetësive.

## 6. AKTIVITETE TE TJERA

### 6.1 Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja

Një nga aktivitetet e rëndësishme e zhvilluar paralelisht me punën për zbatimin e projekteve të investimeve është dhe vlerësimi i nevojave dhe përgatitja e projekteve të reja, aplikimi pranë donatorëve dhe sigurimi i fondeve për financim. Gjatë muajit Mars 2014, u përgatit aplikimi për grant për asistencë teknike në Kornizën Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Projekti i propozuar synon të sigurojë asistencë teknike për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit për projekte infrastrukturore në zonën bregdetare të vendit.

### 6.2 Projekte të bashkëfinancuara nga Bashkimi Europian në kuadër të Programit IPA

#### 6.2.1 IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës

Shuma e financimit është 8 milion € nga të cilat 6.2 financim i IPA kurse 1.8 milion Euro është financim i dy bashkive të Tiranës dhe Durrësit.

Objektivi specifik i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës sociale për grupet me vulnerabël në qytetet e Tiranës dhe Durrësit.

Në vijim të aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit 2014, është përcaktuar tashmë që pas tenderimit të punimeve dhe supervizionit, punimet civile për Projektin e financuar në Bashkinë Durrës të fillojnë zbatimin në datë 12 Janar 2015. Punimet janë parashikuar të zgjasin 18 muaj. Ndërkohë punimet civile për projektin e Bashkise Tiranë fillojnë zbatimin në datë 19 Janar dhe do të zgjasin 18 muaj. Procedurat për monitorimin dhe supervizionin e punimeve civile do të ndiqen nga Delegacionin Europian.

#### 6.2.2 IPA 2013 – Përmirësimi i rrugëve dhe sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale

Objektivi specifik i këtij projekti është të përmirësojë kushtet e jetesës të banorëve në zonat rurale dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të këtyre zonave. Projekti ka dy komponente kryesore:

- Përmirësimin e rrugëve, specifikisht ndërtimin e Lungomares;
  - Ndërhyrje në shkallë të mesme dhe të vogël në ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë;
- (i) Në kuadër të komponentit të parë është programuar ndërtimi i Lungomares. Kosto e këtij komponenti është parashikuar në vlerën rreth 15 milionë Euro. Kjo kosto do të mbulohet përkatësisht nga IPA 2013, në vlerën 12 milionë Euro (11.3 milionë Euro punime civile & 0.7 milionë Euro supervizion) dhe 3 milionë Euro nga Qeveria Shqiptare. Ky komponent është parashikuar të zgjasë nga viti 2014 deri në vitin 2017. Aktualisht projekti i Lungomares është në fazën e hartimit të projektit teknik. Kontrata e punimeve civile parashikohet të lidhet në Prill 2015. Ndërkohë është në proces faza parapërgatitore për blerjen e pemëve dhe aksesoreve të gjelbërimit që do të aplikohet në zonë dhe procesi i hedhjes së rërës në zonat që parashikon projekti.
- (ii) Në kuadër të komponentit të dytë është parashikuar ndërhyrje në shkallë të mesme dhe të vogël në ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë. Financues të këtij komponenti do të jenë KfW me 25.5 milionë Euro; Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro; WBIF me 750 mije Euro, grant për asistencë teknike për studime fizibiliteti; dhe kontribut lokal në vlerën 4 milionë Euro. Komponenti i ndërhyrjes në ndërtimin e ujësjellësave rurale është parashikuar të zgjase nga viti 2015 deri në 2019. Përmes grantit të akorduar nga WBIF do të realizohet hartimi i fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësave Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin. Për këtë

FSHZH është angazhuar në përgatitjen e komenteve dhe sugjerimeve lidhur me kriteret e programit për Marrëveshjen e Financimit, të cilat ia ka paraqitur Ministrisë së Financave. Projekti është ende fazën përgatitore.

### **6.2.3 IPATECH - Teknologji në miniaturë: sinergjia e kërkimeve dhe risive për të përmirësuar zhvillimin ekonomik të Adriatikut**

Projekti zhvillohet në kuadrin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatik. Marrin pjesë 9 organizata nga 5 vende pjesëmarrëse (Shqipëri, Bosnjë, Greqi, Itali, Kroaci). Buxheti total i projektit është 1,748,550 Euro. Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj nga 1 tetor 2012 - mars 2015. Buxheti i llogaritur për FSHZH është 158,895 Euro.

Projekti ka si qëllim krijimin e një rrjeti bashkëpunimi midis organizatave publike dhe private në shtetet pjesëmarrëse duke stimuluar shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në kërkimet dhe inovacionet në sektorin agrorshqimor.

Gjate këtij viti përfunduan procedurat për blerjen e një makinerie në miniaturë. Pas negociatave dhe përfundimit të procedurave u bë e mundur që makineria të vinte nga Italia dhe të instalohet në ambientet e Qendrës së Kërkimeve të Ushqimit, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Kjo i hapi rrugën procesit të pilotimit të makinerisë, nëpërmjet eksperimentimeve të saj.

### **6.2.4 Projekti MONTEAL**

Projekti MONTEAL synon të investojë në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe ekonomik nëpërmjet menaxhimit me pjesëmarrje të turizmit në zonën ndërkufitare të rajoneve Kelmend, Shkrel, Andrijevicë, Berane dhe Plavë. FSHZH është i angazhuar në rolin e aplikantit lider dhe organizata partnere në Malin e Zi është Regional Tourism Organization-Bjelasica dhe Rajoni i Komovit.

Buxheti total i projektit është 480,167 Euro ku pjesa që do të menaxhohet nga FSHZH përfshin 248,495 Euro.

Në fund të vitit 2014 projekti ka përbushur në kohë disa prej veprimtarive të parashikuara sic kanë qenë përgatitja e një projekti teknik për ndërhyrjet në infrastrukturë turistike me synim valorisimin e aseteve turistike në komunat e Kelmendit dhe të Shkrelit. Punimet për infrastrukturën turistike që shoqërojnë rrugën thuajse gjatë gjithë itinerarit të vet kane nisur gjate muajin Nentor dhe parashikohet të vazhdojnë deri në prill të vitit të ardhshëm. Ndërhyrjet veç krijimit të disa vendpushimeve në pika nga ku mund të soditet panorama mbresëlënëse e zonës së Alpeve, do të plotësojnë me sheshpushime e vende parkimi edhe pika të tjera që paraqesin interes për udhëtarin e pushuesin. Pjesë e këtyre ndërhyrjeve do të jenë edhe sistemimi dhe rritja e sigurisë në shtigje që çojnë pushuesit drejt pikave me interes turistik.

### **6.2.5 Projekti HERA**

HERA është akronimi i projektit të financuar nga programi IPA Adriatik të titulluar "Menaxhimi i qëndrueshëm i turizmit të trashëgimisë kulturore".

Projekti HERA konsiston midis të tjerave në realizimin e projekteve pilot dhe promovimin e "Fototekës Marubi" në qytetin e Shkodrës, si një nga institucionet me vlera të mëdha kulturore, turistike dhe historike në Shqipëri.

Pas shpalljes fituese të studios hollandeze, Fondi Shqiptar i Zhvillimit zhvilloi një cikël konsultimesh me grupet e interesit për zbatimin e projektit të "Restaurimit dhe Muzealizimit të Fototekës Kombëtare Marubi" në Shkodër.

Në muajin dhjetor u dorëzua projekti teknik përfundimtar në të cilin janë reflektuar edhe ndryshimet në rritjet e kostos së projektit. Në këto kushte kanë nisur bisedimet me Qeverinë Shqiptare, Fondin Shqiptaro- Amerikan të Zhvillimit dhe partnerë të tjerë, për të mundësuar bashkëfinancimin e këtij projekti. Punimet civile parashikohet të nisin në fillim të vitit 2015 dhe do të zgjasin 1 vit. Ndërkohë është duke u përgatitur paketa e tenderit për punimet e rikonstruksionit si dhe dokumentacioni për marrjen e lejes mjedisore dhe lejen e restaurimit nga IMK në muajin janar 2015.

### **6.3 Programi i Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut**

Përpjekje dhe aktivitete strategjike janë ndërmarrë nga FSHZH edhe për të harmonizuar rolin dhe aktivitetin e institucionit me programin e Qeverisë së re. Gjatë muajit dhjetor 2013, FSHZH në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe Deputetë të Qarkut Vlorë u organizua Konferenca mbi "Programin e Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut". Ky Program Investimesh përfshin Programin e Rrugëve Rurale, Programin e Rrugëve Urbane, Programin e Ujësjetës-Kanalizimeve si dhe Programin e Rikualifikimit Urban.

Gjatë vitit 2014 FSHZH në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Bregdetit të Jugut ka vijuar punën për kontrollin e projekteve teknike për 143 projektet infrastrukturore të propozuara në kuadër të këtij programi. Krahas kontrollit të projekteve teknike në tavolinë, janë organizuar vizita në terren nga specialistet e FSHZH, në bashkëpunim me përfaqësues të NjQV-ve dhe projektuesve. Për projektet të rishikuara janë hartuar komentet përkatëse të cilat u janë dërguar Njësiteve të Qeverisjes Vendore. Programi i propozuar është promovuar pranë donatoreve dhe institucioneve financiare me synim sigurimin e financimit. Në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2014 ka financuar një sërë projektesh ambicioze në këtë zonë. Projektet fokusohen në furnizimin me ujë në Sarandë, Himarë dhe Ksamil, sistemimin dhe gjelbërimin vijës bregdetare të Vlorës dhe rrugës nacionale Plepa (Durrës) – Vlorë.

Ndërkohë FSHZH është përgatiti një studim fizibiliteti për rrugën e Lumit të Vlorës, i cili është dërguar pranë Fondit Kuvajitian për Zhvillim Ekonomik për të mundësuar financimin e tij.

### **6.4 Përgatitja e Masterplanit për Zonën e Alpeve**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka nisur punën për përgatitjen e një master plani për të ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së Alpeve. Masterplani është konceptuar si faza e parë e një projekti zhvillimi që do të financohet prej Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB).

Përgatitja e Master Planit bëhet e mundur nga një grant i instrumentit financiar të investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Fokusi i Master Planit do të jetë vlerësimi i potencialit turistik të zonës së Alpeve dhe identifikimi i ndërhyrjeve të nevojshme në infrastrukturën dhe shërbimet publike. Gjatë këtij viti, u arrit të hartoheshin termat e referencës për përgatitjen e Masterplanit për zonën e Alpeve nga një konsulencë e huaj.

Në fund të muajit maj u publikua Thirrja për Shprehje Interesi nga kompani lokale dhe ndërkombëtare, e cila u mbyll në fund të muajit Korrik. Gjatë muajit Shtator ka përfunduar shortlistimi i 6 ofertuesve më të përshtatshëm dhe është marrë aprovimi i donatorit. Në vijim 6 konsulentët e përzgjedhur do të japin propozimet e tyre teknike nga të cilat do të përzgjidhet vetëm një. Kontrata parashikohet të lidhet në fund të muajit Janar 2015 dhe të përfundojë në harkun kohor të 18 muajve.

### **6.5 Bashkëpunimi strategjik Shqipëri-Kosovë**

Një tjetër angazhim i FSHZH në vitin 2014 ka qenë edhe kontributi në bashkëpunimin strategjik Shqipërisë dhe Kosovës. Për këtë arsye që nga fillimviti Fondi Shqiptar i Zhvillimit u përfshi në përpjekje për rivitalizimin e angazhimit për bashkëpunim të ngushtë institucional, ekonomik e kulturor mes Shqipërisë dhe Kosovës. Një proces intensiv komunikimi me përfaqësues të Njësive të Qeverisjes Vendore në të dy anët e kufirit për identifikimin e projekteve prioritare që do të lehtësonin bashkëpunimin u inicua nga FSHZH që në fillim të vitit. Në 7 maj, Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me autoritet lokale dhe Agjensinë e Zhvillimit të Rajonit Ekonomik Perëndimor në Kosovë organizuan takimin e përbashkët të përfaqësuesve të autoriteteve lokale të brezit kufitar Shqipëri-Kosovë me temë “Krijimi i sinergjive të përbashkëta zhvillimi”. Organizimi i takimit të përbashkët të autoriteteve lokale të brezit kufitar synoi krijimin e një hapësire diskutimi për të rrahur ide rreth mundësive konkrete për bashkëpunim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social. Fokusi i takimit ishte edhe hartimi i një plani veprimi dhe formalizimi i strukturave që do të mundësojnë, lehtësojnë e mbikqyrin zbatimin e projekteve si dhe hartimin e përmbushjen e politikave në nivel qendror e vendor. Në të ardhmen planifikohet një takim orientues për anëtarët e strukturave si dhe mbajtjen në vazhdimësi të komunikimit mes palëve.

## 6.6 Aktivitete të tjera

Departamenti i Zhvillimit Rajonal (DZHR) gjatë vitit 2014 ka vazhduar angazhimin e vet për përmbushjen e detyrave në bashkëpunim të ngushtë me Departamentet e tjera të FSHZH-së si dhe ka çuar më tej punën për mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore dhe harmonizimin me programin e Qeverisë së re. Bazuar në bindjen se FSHZH ka gjithë kapacitetet e nevojshme për një rol më të rëndësishëm në zhvillimin rajonal në vend ka qenë në qendër të vëmendjes dhe përpjekjeve të DZHR orientimi i institucionit drejt Zhvillimit Rajonal që harmonizon prioritet kombëtare me nevojat rajonale duke u kujdesuar njëkohësisht për rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së njësive të qeverisjes vendore në marrëdhëniet me qeverinë dhe donatorët.

Gjatë kesaj periudhe, FSHZH u angazhua në studimin e kuadrit të saj institucional dhe ligjor për të analizuar mundësinë e marrjes së një roli statutor në sferën e zhvillimit rajonal në vend, rol i cili përgjatë viteve të fundit ka qenë gjithnjë e më domethënës duke kryer për disa vite me radhë rolin e sekretariatit teknik për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, apo duke mbështetur plane/strategji të zhvillimit në shume rajone të vendit. Studimi, i përgatitur nga ekspertë të EMA (European Movement Agency), kishte si qëllim kryesor të identifikojë cilat janë opsionet e ndryshme që do t'i mundësonin FSHZH-së një rol domethënës në fushën e Zhvillimit Rajonal në vend, nga pikëpamja e instrumenteve kombëtare si edhe nga pikëpamja e potencialit për thithjen e fondeve europiane, meqenëse Bashkimi Europian dhe Instrumenti për Ndhimën Para anëtarësimit (IPA) janë prej disa vitesh donatori kryesor në Shqipëri.

Gjatë këtij viti është përgatitur aplikimi për grant për asistencë teknike në Kornizën Investuese për Ballkanin Perëndimor. Projekti i propozuar synon të sigurojë asistencë teknike për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit për projekte infrastrukturore në zonën bredetare të vendit.

Gjatë kesaj periudhe u kontraktua një konsulence e huaj me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të brendshme të FSHZH-së në menaxhimin efektiv të projekteve. Përmes të mësuarit dixhital dhe trajnimit dy ditor, një pjesë e stafit të FSHZH u trajnuar dhe u çertifikua në PRINCE2 (PROjects In Control Environments) – metodë standarte për menaxhimin efektiv të projekteve e njohur në nivel ndërkombëtar.

Ndërkohë në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale”, u realizua një studim mbi vlerësimin e ndërhyrjes në disa raste studimi për rrugët dytësore dhe lokale të financuara në kuadër të PRDL dhe PK III.

Rezultatet e këtij vlerësimi janë mjaft pozitive dhe inkurajuese. Ato janë përmbledhur në një raport i cili është vendosur në dispozicion të të interesuarve që prej muajit Korrik 2014.

Gjithashtu në fund të tremujorit të fundit, DZHR kryesoi bërjen e studimit të fizibilitetit për Rikonstruksonin e rrugës së lumit të Vlorës, për t'u financuar nga Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab. Projekti i Rikonstrukcionit të Lumit të Vlorës synon rikonstrukcionin e 94.2 km rrugë. Rruga do të mundësojë lidhjen e dy rrugeve nacionale (SH4-SH8) dhe përfshin edhe një degëzim që mundëson lidhjen me qytetin e Vlorës. Projekti është parashikuar të ketë një kosto totale prej 93,600,000 USD. Pjesa që i kërkohet Fondit Kuvajtian është 78,000,000 USD. Pjesa tjetër do të mbulohet nga Qeveria Shqiptare.